



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:083664

Datë: 03.06.2024

Numri i dokumentit: 05772983

PKR.nr.606/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA, në përbërje nga trupi gjykues prej tre gjyqtarët profesionistë, përkatësisht gjyqtari Naser Foniqi – kryetar i trupit gjykues dhe Fatime Dërmaku e Kushtrim Shyti, anëtarë të trupit gjykues, me bashkëpunëtoren profesionale **Arbenita Hoxha Koleci**, në çështjen penale të akuzuarit B.A., i akuzuar për shkak të veprës penale Ndhima në kryerjen e veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 1 lidhur me neni 33 par. 2 lidhur me nenin 31 të Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës – në vijim KPRK, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda **PP/I.nr.114/2020, të datës 30.04.2021**, pas shqyrtimit gjyqësor, të hapur për publikun, të mbajtur më datë 18.01.2024, në të cilin ishin të pranishëm i akuzuari B.A. me mbrojtësen e tij av. Feride Xani dhe të akuzuarit tjerë me mbrojtësit e tyre, pas njoftimit të prokurorit të shtetit PP.I.nr 114/20 të datës 02.02.2024, me datë **23.02.2024**, mori dhe publikisht, shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të akuzuarit

B.A., i biri i M. dhe Q., e vajzërisë S., i lindur me datë ..., në fshatin ..., Komuna Gjakovë, ku edhe jeton, me numër personal ..., shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, **ka qenë nën masën e paraburgimit nga data 14.07.2020 deri me datë 08.04.2021**,

Konform nenit 362, par. 1, nënpar. 1.1 të Kodit Nr. 08/L-032 të Procedurës Penale – në vijim KPP,

REFUZOHET AKUZA

S e p s e: me datë 14.07.2020 rreth orës 17:00 derisa të pandehurit B.D. dhe A.D. kanë qenë nën masën e përgjimit, vëzhgimit, pasi janë furnizuar kanë transportuar substanca narkotike nga Gjakova për në Prishtinë, ashtu që të pandehurit R.I.– taksist, i akuzuari A.B. dhe i akuzuari B.D. me veturën **“Touran”** në ora 17:00 kanë arritur në Gjakovë, e në hyrje të qytetit janë takuar me tani të akuzuarit B.A. dhe A.K., të cilët kanë qenë duke i pritur me veturën **“Alfa Romeo”** me targa ..., e ku i pandehuri A.K.ka zbritur nga vetura e tyre dhe është vendosur në veturën e tipit **“Skoda”** me targa ...me mbishkrim **“T...”** të cilën e drejtonte i pandehuri R.I., e pas këtij takimi me të tri veturat e tyre, duke përcjellë njëri tjetrin kanë lëvizur në drejtim të Liqenit të

Radoniqit në një mal për ta bërë bartjen e dy thasëve me narkotikë, ndërsa pas marrjes së narkotikëve, të pandehurit B.D. me veturën e tipit “Touran” ngjyrë hiri, me targa ... dhe të pandehurit A.B. e R.I. me veturën e kompanisë “T...” si dhe vetura “Alfa Romeo” në të cilën ishin të pandehurit B.A. e A.K. duke i përcjellë deri te udhëkryqi Klinë – Gjakovë, pastaj vetura “Alfa Romeo” ka vazhduar në drejtim të Gjakovës, ndërsa veturat e tipit “Touran dhe Skoda” janë nisur në drejtim të Prishtinës, e në dalje të autostradës “I.R.” në V. te rrethi afër pompës “Sh...” aty i ka prituri i pandehuri A.D. me veturën e tipit “Golf 7” ngjyrë e kaltër, me targa ..., e të cilën ishte duke e drejtuar i pandehuri A.Sh., dhe në momentin që janë bërë bashkë të tri veturat, Policia e Kosovës/DHTN kanë arritur t’i ndalojnë dhe arrestojnë të dyshuarit e lartcekur, ndërsa gjatë kontrollit të personave dhe veturave, në veturën “T...” në bagazhin e saj janë gjetur 13 kg e 800 gram substancë narkotike e llojit marihuanë, ndërsa tek i pandehuri R.I. (taksisti) gjatë kontrollit i është gjetur një sasi e vogël e substancës narkotike e llojit marihuanë me peshë prej 0.9 gram, po ashtu gjatë bastisjes së banesës e cila gjendet në Rr. “A.K.” L... të cilën e kanë shfrytëzuar B.D. dhe A.D. në një dhomë gjumi, nga policia janë gjetur disa paketime të mbushura me substancë narkotike të llojit marihuanë me peshë prej 6 kilogram e 206.6 gram, folje alumini dhe qese të ndryshme, tri peshore digjitale që shërbejnë për matjen e substancave narkotike, dhe një pistoletë e tipit “Crvena Zastava”, e zezë me një karikator dhe tre fishekë, po ashtu është bërë bastisja dhe në banesën e të pandehurit A.Sh. në Rr. “A.Ç.”, hyrja ..., kati ..., nr... në Prishtinë, gjatë kontrollit janë gjetur 11 paketime të mbështjella me folje alumini dhe një cigare me narkotik të llojit marihuanë me peshë 25.1 gram dhe para të letrës në vlerë prej 195 Euro, ndërsa tek i pandehuri B., në xhep i janë gjetur para të letrës në vlerë prej 7240 Euro, ndërsa te i pandehuri A.D., në kuletë i janë gjetur para në vlerë prej 205 Euro, si në dispozitivin e dytë të pandehurit A.Sh., R.I., B.A., A.K., A.B. kanë ndihmuar të pandehurit B.D. dhe A.D. në mënyrën, transportin, bartjen e substancës narkotike të llojit marihuanë nga qyteti i Gjakovës për në Prishtinë.

- me këto veprime, kishte për të kryer veprën penale Ndhurma në kryerjen e veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 1 lidhur me neni 33 par. 2 lidhur me nenin 31 të KPRK,
- **pasi që prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza.**
- Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

ARSYETIMI

Pas kallëzimit penal të Policisë së Kosovës, Njësia e Hetimeve Stacioni Policor DHTN-1 Prishtinë nr.2020-DHTN-332, të datës 15.07.2020, Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktakuzën **PP/I.nr.114/2020, të datës 30.04.2021**, e ka akuzuar të pandehurin B.A., për shkak të veprës penale Ndhurma në kryerjen e veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 1 lidhur me neni 33 par. 2 lidhur me nenin 31 të KPRK.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 18.01.2024, pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, ka kërkuar fjalën mbrojtëseja e B.A., Av. Feride Xani, e cila ka informuar gjykatën se për çështjen penale për të cilën është akuzuar i mbrojturi i saj, i njëjti është dënuar me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë PKR.nr.209/2020 të datës 07.02.2023 dhe vendimi është bërë i formës së prerë, andaj ka kërkuar të shikohet aktgjykimi dhe aktakuza në fjalë e pastaj të vlerësohet nëse kjo çështje është e gjykuar.

Ndërsa, pas fjalës së mbrojtëses së të akuzuarit ka kërkuar fjalën prokurori i shtetit, i cili ka deklaruar se sa i përket kësaj çështje do të deklarohet në seancën e radhës pasi ta shikoj aktgjykimin e përmendur nga avokatja dhe aktakuzën të cilën e posedon.

Me shkresën të datës 02.02.2024, prokurori i shtetit e ka njoftuar gjykatën se ka bërë krahasimin e aktakuzës me nr. PP.I.nr.114/20, me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Gjakovë PP.I.nr.79 /20 të datës 05.10.2020 dhe aktgjykimin të Gjykatës Themelore në Gjakovë, PKR.nr.209/2020 dhe ka ardhur në përfundimin se bëhet fjalë për personin e njëjtë dhe objektin e njëjtë të veprës penale, andaj bazuar në nenin 4 të KPP ka heqë dorë nga ndjekja penale ndaj të akuzuarit B.A. për veprën penale Ndiurma në kryerjen e veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 1 lidhur me neni 33 par. 2 lidhur me nenin 31 të KPRK, me arsyetim se për të njëjtën çështje është zhvilluar procedura penale dhe nga Gjykata Themelore në Gjakovë është marrë aktgjykim, i cili është i plotfuqishëm.

Pasi që, prokurori i shtetit është tërhequr nga ndjekja penale ndaj të akuzuarit B.A., i akuzuar për shkak të veprës penale si në dispozitiv të këtij aktgjykim, **gjykata** mori aktgjykim refuzues.

Vendimi për shpenzimet procedurale u mor në bazë të nenit 453, par. 1 të KPP.

Nga sa u tha më lart, dhe në bazë të nenit 362, par. 1, nënpar. 1.1 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykim.

Ky aktgjykim është përpiluar me datë 23.02.2024, por deri tani nuk është arritur të vendoset në SMIL për shkak të vonesave për lirim parashtrës.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr.606/2022, datë 23.02.2024

Bashkëpunëtoreshë profesionale,
Arbenita Hoxha Koleci

Kryetari i trupit gjykues,
Naser Foniqi

UDHËZIMI PËR MJETET JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykim, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar **brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh**, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimin. Ankesa bëhet përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës, me seli në Prishtinë.